

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Keanu Reeves feston 62-vjetorin, nga “The Matrix” te “John Wick”, karriera e yllit më të dashur të Hollivu dit
ADRESA	https://indeksonline.net/keanu-reeves-feston-62-vjetorin-nga-the-matrix-te-john-wick-karriera-e-yllit-me-te-dashur-te-hollivudit/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 18:15:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	3 shtator 2026, 17:49:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	696ea12241a7458096b4cfa3bdc944c36508797bbc29b5505bf3c31b5f5ffc9
TEKSTI	a2d7524f97a6810ec8a8bfb81394496a31dbe91b23660b973592b8c3a9c90d73
PAMJA	c2a05f41529b824d996d43b125509cbf807eeab45b46d852354a178937b38241

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b72f6f9a7a45093db815262fb75ac332efbc13665ac50292e5a89391f3a57ae9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3fbe5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b72f6f9a7a45093db815262fb75ac332efbc13665ac50292e5a89391f3a57ae9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)





SHPËRNDAJE








19:49 / E Enjte, 03 Shtator 2026 / Z S

Keanu Reeves feston 62-vjetorin, nga “The Matrix” te “John Wick”, karriera e yllit më të dashur të Hollivudit



Keanu Reeves mbushi dje 62 vjeç, duke shënuar më shumë se katër dekada në skenë dhe në ekran, sipas “The Guardian”.

Aktori kanadez, i lindur më 2 shtator 1964 në Bejrut të Libanit, është kthyer në një nga figurat më të njohura të kinemasë botërore, veçanërisht falë roleve të tij në “The Matrix” dhe “John Wick”.

Nga fillimet te fama ndërkombëtare

Reeves nisi të merrej me aktrim që në moshë të re dhe gjatë viteve 1980 u shfaq në produksione televizive, reklama dhe filma.

Hapat e parë të rëndësishëm në kinematografi i realizoi në filmat si “River’s Edge”, “Bill & Ted’s Excellent Adventure” dhe “My Own Private Idaho”.

Në vitin 1994, roli i tij në “Speed”, përkrah Sandra Bullock, e shndërroi në një yll ndërkombëtar të filmave aksion.

Gjatë kësaj periudhe, ai fitoi edhe vlerësime të rëndësishme nga MTV-ja dhe çmime të tjera të industrisë.

“The Matrix” – roli që ndryshoi karrierën

Momenti më i madh i karrierës së Reeves, erdhi në vitin 1999, kur ai interpretoi Neo-n në “The Matrix”.

Filmi u bë një fenomen global dhe fitoi katër çmime “Oscar”, ndërsa Reeves mori çmimin “MTV Movie Award” për performancën më të mirë, së bashku me Laurence Fishburne.

Filmi fitoi gjithashtu çmimin “Saturn Award” për filmin më të mirë fantastiko-shkencor.

Roli i Neo-s e vendosi Reeves përgjithmonë mes yjeve më të mëdhenj të kinemasë së aksionit dhe fantastiko-shkencës.

“John Wick” – rikthimi spektakolar

Në vitin 2014, Reeves mori rolin e vrasësit profesionist John Wick.

Filmi i dha një tjetër kthesë karrierës së tij dhe u shndërrua në një nga ekskluzivitetet më të suksesshme të aksionit të viteve të fundit.

Seria vazhdoi me “John Wick: Chapter 2, Chapter 3 – Parabellum dhe Chapter 4”.

Për interpretimin e tij, Reeves ka marrë nominime të shumta, përfshirë nominime për çmime “Saturn Award” dhe “People’s Choice Award”.

Në vitin 2024, ai fitoi çmimin “Jupiter Award” për aktorin më të mirë ndërkombëtar.

Aktor, muzikant dhe autor

Përtej kinemasë, Reeves ka pasur edhe një karrierë në muzikë.

Ai është bashkëthemelues dhe basist i grupit alternativ rock “Dogstar,” dhe vazhdoi të merret me muzikë paralelisht me aktrimin.

Ai është përfshirë gjithashtu në projekte letrare.

Reeves bashkëkrijoi serinë e romaneve grafike BRZRKR, ndërsa më pas bashkëpunoi me shkrimtarin, China Miéville për romanin “The Book of Elsewhere”.

Një jetë personale larg vëmendjes

Pavarësisht famës së jashtëzakonshme, Reeves është njohur për mënyrën relativisht private dhe të thjeshtë të jetesës.

Një nga periudhat më të dhimbshme të jetës së tij lidhet me marrëdhënien me Jennifer Syme.

Çifti humbi vajzën e tyre, e cila lindi e pajetë në vitin 1999.

Dy vite më vonë, në vitin 2001, Syme humbi jetën në një aksident automobilistik në Los Anxheles.

Ngjarja ndikoi thellë tek aktori dhe për një periudhë ai u tërhoq nga jeta publike.

Vitet e fundit, jeta sentimentale e Reeves është lidhur me artistën amerikane, Alexandra Grant.

Dyshja kishin bashkëpunuar prej vitesh në projekte artistike dhe botuese, ndërsa lidhja e tyre u bë publike në vitin 2019.

Ata kanë vazhduar të shfaqen së bashku në evente publike, duke ruajtur megjithatë një profil relativisht të ulët.

Një karrierë që vazhdon

Nga rolet e tij si, Ted Logan, Jack Traven dhe Neo, deri te John Wick, Reeves ka ndërtuar një karrierë që përfshin disa prej filmave më të njohur të dekadave të fundit.

Në 62-vjetorin e tij, Keanu Reeves mbetet një nga aktorët që ka arritur të kombinojë suksesin komercial, karrierën e gjatë dhe një profil relativisht modest jashtë ekranit, duke ruajtur një lidhje të fortë me publikun në mbarë botën.


Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)



- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)






- [“1 ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i dëboi nga Prizreni ushtarët serbë?](#)



- [Shoferi i dehur gjyketet 2 herë, brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)



- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)

- [Aksidenti i rëndë në autostradën "Ibrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



Të fundit nga Showbiz

- [23:30 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Motra e Laurent Krasniqit thyen heshtjen pas humbjes së rëndë](#)
- [23:00 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Eva në deti, 'nxehet' interneti](#)

- [22:30 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Bad Bunny vazhdon të thyejë rekorde, 7 çmime Emmy për shfaqjen e Super Bowl](#)
- [22:00 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Pamje ekskluzive, martohet vajza e Bedri Hamzës, kryetari i PDK-së vallëzon me çiftin](#)
- [21:30 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Pse bën paraqitje publike nu*do? Bianca trazon rrjetin](#)
- [21:00 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Doarsa, Hykmetja apo Jehona? Ja cila deputete e LDK-së ka më shumë ndjekës në Facebook](#)



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.